

Diana Al Hadid (amerikane, e lindur në Alepo të Sirisë më 1981, jeton dhe punon në Nju Jork)

Pa titull (Ura e Prizrenit), 2018

Çelik, lesh xhami, gips polimer, suva, fletë metalike, pigment

Pllakë diptike, secila pllakë ka madhësinë 84 x 90 x 4 in. (213.4 x 228.6 x 10.2)

Siç tregon edhe vetë titulli, kjo vepër artistike është frymëzuar nga ura historike e gurit në Prizren, Kosovë.



Margo Sawyer (amerikane, e lindur më 1958, jeton dhe punon në Ostin, Teksas)

Spirale sinkronike, 2018

Xham i ngjyrosur me dorë, çelik, çelik i pandryshkshëm , alumin dhe ngjyrë

114 × 240 × 180 in. (289.6 × 609.6 × 457.2 cm)

Margo Sojer (Margo Sawyer) me veprat e saj hulumton marrëdhënien midis hapësirës dhe përsosmërisë; vendeve ku arkitektura dhe rituali takohen për të krijuar cilësi të përsosmërisë që nxit vështrimin brenda vetë vizitorit. Ngjyra zë vendin kryesor në veprat e saj. Skulptura në ambasadën amerikane është frymëzuar nga dizajnet e brendshme dhe motivet e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës.




Virginia Scotchie (amerikane, e lindur më 1955, jeton dhe punon në Kolumbia, Karolinë të Jugut)

Seria e punimit të objekteve, 2018

Punime qeramike, 20 objektet dallojnë në madhësi nga 12-15 inç të lartë dhe 6-8 inç të gjerë/thellë.

Baza e skulpturës së qeramikës të punuar nga Virxhinia Skoçi (Virginia Scotchie) rrjedh nga ideja për të marrë diçka nga një objekt dhe për ta lidhur me një tjetër përmes ndarjes së copave dhe pjesëve të tyre. Objektet nga qeramika që ndodhen në ndërtesën e re të ambasadës amerikane u frymëzuan nga arkitektura dhe elementet historike të jetës së përditshme në Kosovë.



Gyöngy Laky (amerikane, e lindur më 1944 në Budapest, Hungari, jeton dhe punon në San Francisko, Kaliforni)

Në kërkim, 2016

Degë të ndryshme, dru komercial, ngjyrë akrilike, plumba për ndërtim (vidha zbukuruese) 64 x 36 x 4in. (162.6 x 91.4 x 10.2cm)

Gyöngy Laky (Gyöngy Laky) e tërheqin materialet modeste dhe metodat e thjeshta e të drejtpërdrejta të ndërtimit me duar, të cilat i lidh me zgjuarsinë themelore, bazë të njeriut për punimin e gjësendeve. Pikëpyetjet e saj kërkojnë vëmendje dhe diskutim.



Eva LeWitt (amerikane, e lindur më 1985, jeton dhe punon në Nju Jork)

Pa titull (B8), 2018

Shkumë poliuretani, lateks dhe plastikë $89 \frac{3}{4} \times 86 \frac{5}{8} \times 2 \frac{3}{4}$ in. ($228 \times 220 \times 7$ cm)

Eva LeWitt (Eva LeWitt) punon me materiale të buta si plastika, llastiku, goma, shkuma nga poliuretani për të krijuar skulptura varëse dhe vepra artistike në mur. Kompozimet e saj abstrakte trajtojnë çështje skulpturore si vëllimi, pesha dhe tensioni ndërmjet punimeve industriale dhe të punuara me dorë.

